

AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ALPHA DIAGNOSTIC” shpk
Ne Durres, sot me date 01/02/2024, ortaket themelues te shoqerise
“ALPHA DIAGNOSTIC” shpk.

Z. Zek Palokaj, i biri i Jakin, i datelindjes 12.04.1989 , lindur ne Fushë,Arrez ,e banues ne Durres , shtetas Shqiptare, madhor, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me karte identiteti me numer **I90412091W**.

Znj. Antuela Veliko e bija Hairi , i datelindjes 25.09.1993, lindur ne Sarande e banues ne Durres, shtetas shqiptar, madhor, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me karte identiteti me numer **J35925044E**.

Te cilet me cilesine e “Ortakeve themelues” kerkuan redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklaroi se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, **“ALPHA DIAGNOSTIC” shpk.**

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria “ALPHA DIAGNOSTIC” shpk

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria **“ALPHA DIAGNOSTIC” shpk**, eshte nje shoqeri tregetare, e themeluar nga shtetasit shqiptare:

Z. Zek Palokaj, Znj. Antuela Veliko , te cilet pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.



**Neni 3
Selia**

Shoqeria e ka seline ne: Lagjia 1, Rruga "Taulantia", Njesi me Numer Pasurie 26/20/ND+1-1, Zone Kadastrale 8512, Durres. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filial, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakeve themelues.

**Neni 4
Objekti i veprimtarise**

Laborator Klinik- Biokimik. Dhenie me qera ambiente.

**Neni 5
Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

**KREU II
Kapitali
Neni 6
Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 200,000 (dy milion e gjashtëqind mijë lekë), i cili ndahet ne 2 kuota, ne raport me kontributin e dhene nga ortakët ne shoqeri ku ortakët zoterojne kuota te ndare si me poshte :

Ortaku, Z. Zek Palokaj,: zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 102,000leke, qe perbejne 51 % te kapitalit themeltare te shoqerise.

Ortaku, Znj. Antuela Veliko : zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 98,000 leke, qe perbejne 49 % te kapitalit themeltare te shoqerise.

**Neni 7
Transferimi i kapitalit**

Kuota e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.



Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.
Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaket e shoqerise jane organi vendimmarres i shoqerise. Ortaket e shoqerise jane organi vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaket vendosin per çeshtje si :

- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortaket e shoqerise regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per :

- a) Miratimine pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim , perveç rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.



Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë "ALPHA DIAGNOSTIC" shpk caktohet brenda ortakërisë. Ortaku Znj. Antuela Veliko emërohet Administrator i shoqërisë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërteritje. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë e ortakëve të shoqërisë.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) Kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregëtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Perfaqësojë shoqërinë tregëtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabel të shoqërisë;
- d) Përgatit dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve të paraqesin këto dokumenta përpara asamblese së përgjithshme për miratim
- e) Krijoi një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- f) Kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë sic parashikohet në ligjin për QKR.
- g) Raportoi përpara asamblese së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare.

Administratori është i detyruar të thërrasë në mbledhjen e asamblese në rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultoni ose ekzistoni rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë me të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultoni në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Administratori, si së bashku edhe vecas njëri tjetrit, kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori e perfaqësojnë shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe /ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ja jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhënie me të tretet nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merret përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose për të tretët nuk mund të injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11
Viti Financiar

Viti Financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht , viti i par Financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet ne 31 dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te ortakve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk esht njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 , date 3.5.2007 "Per Qendren Kombtare te Biznesit"
- e) me vendim te gjykates

Ne kete rast Asamblea e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " shoqeri ne likuidim e siper"

Neni 13
Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit "Per tregtaret dhe shoqerit tregtare", Kodit Civil dhe cfar do ligji tjetër specific ne Republikën e Shqiperis.


Neni 14
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare "ALPHA DIAGNOSTIC" shpk nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin , mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

ORTAKET THEMELUES

Zek Palokaj

Zek Palokaj


Antuela Veliko

Antuela Veliko
